



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL. Anr.489/ 2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi, kryesues, Faton Ademi, dhe Zyhdi Haziri, anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lartë Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi për ankesën e Dushan Milunoviq nga subjekti politik GI SDP Oliver Ivanoviq, paraqitur kundër subjektit politik Lista Serbe, për shkak të Shkeljes së Kodit të Miresjelljes, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Refuzohet si e pabazuar** ankesa e Dushan Milunoviq nga subjekti politik GI SDP Oliver Ivanoviq, paraqitur ndaj subjektit politike Lista Serbe.

### A r s y e t i m

PZAP, më datë 24.10.2017 ka pranuar një ankesë nga Dushan Milunoviq nga subjekti politik GI SDP Oliver Ivanoviq të dorëzuar nëpërmjet postës me datën 21.10.2017, të parashtruar ndaj subjektit politik Lista Serbe për arsye se siç thekson ai përfaqësuesi i Listës Serbe Zoran Mojsiloviq ka parashtruar ankesë në PZAP kundër subjektit politik GI SDP Oliver Ivanoviq dhe kundër tij me pretendimin se i njëjti ka marre pjesë gjatë mbulimit të materialeve të zgjedhore. Parashtruesi i ankesës thekson se në fotografit e bashkangjitura në ankesën e Listës Serbe ai nuk ka qene në ato foto dhe se nuk ka marre pjese në ato veprime, pasi që siç thekson ai dje ka qenë tërë ditën në vendlindjen e tij. Parashtruesi i ankesë thekson se kjo ankesë i ka paraqitur problem dhe një tentim për te njollosur nderin dhe imazhin e tij

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve ankimore në ankesë nuk ka ofruar dëshmitë të qarta dhe bindëse për të vërtetuar pretendimet në ankesën e parashtruar, në kuptim të nenit 117 par 3 të LZP-së ku është përcaktuar: **“se vendosja për ankesa dhe apele nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”**. Paneli gjatë vendosjes së ankesës i shqyrton dhe i heton me kujdes të gjitha provat e bashkangjitura në

ankesë dhe kurë vlerëson se pretendimet ankimore nuk janë mirë të bazuara në fakte dhe nuk i plotësojnë standardet ligjore ankesat e tilla i refuzon.

Paneli vlerësoj se ankesa e parashtruar nga parashtruesi i ankesës nuk i plotësojë këto standarde ligjore. Kjo për faktin se pala ankuese nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për tu vërtetuar ajo për të cilin pretendohet me ankese, andaj paneli nuk pati mundësi të vërtetojë në mënyrë bindëse dhe të qartë ashtu si pretendohet në ankesë.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
ZL Anr. 489/2017 më datën 24.10.2017

**Kryesuesi i Panelit**  
**Fejzullah Rexhepi**



**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa.*